

VENDIM
Nr.425, datë 2.7.2004

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE
TË DREJTORIVE ARSIMORE RAJONALE DHE ZYRAVE ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet “Drejtör”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” në drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes 1 – “Diplomë e shkollës së lartë” është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) të jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) të jetë 0.

5. Shtesa për pozicion të jetë sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

6. Punonjësit e tjerë të drejtorive arsimore rajonale dhe të zyrave arsimore të vazhdojnë të paguhën sipas lidhjes III-7/5 të urdhrit nr.4, datë 1.6.2001 “Për pagat e punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.”.

7. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.1

EMËRTIMI	PAGA MUJORE			
	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
	1	2	3	4
	Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Drejtör i drejtorive arsimore rajonale	9 000	2%	0	40 000
Drejtör i zyrave arsimore Përgjegjës sektori në drejtoritë arsimore rajonale	9 000	2%	0	30 000
Përgjegjës sektori në zyrat arsimore Specialist në drejtoritë arsimore rajonale	9 000	2%	0	20 000
Specialist në zyrat arsimore	9 000	2%	0	15 000